



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2021:048324

Datë: 23.03.2021

Numri i dokumentit: 01626300

P.nr.102/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Elmije Troshupa, duke vendosur në lëndën penale kundër të pandehurit A.B.nga C.– Sh., të cilin e akuzon Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.1049/21 dt.13.03.2021, për shkak të veprës penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-se, në shqyrtim fillestar publik, të mbajtur me dt.13.03.2021, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit Rrahim Podvorica, të pandehurit, dhe mbrojtësit të tij Nebih Troshupa av.ne Lipjan, në të njejtën datë, merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

A. B., i lindur me dt.2.1...19.. nga Babai F..., me vendbanim ne C.. Lagja nr... ne E... te Sh..., ku edhe jeton, dhe e ëma F.. e vajzërisë H., i gjendjes se dobët ekonomike, ka te kryer shkollën e larte ne drejtimin e g..., shqipëtar, shtetas i R. së Sh..., me pare i pa dënuar, ka qëndruar ne ndalim nga data 13.03.2021 nga ora 04.00 h. deri e gjykim.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me dt. 13.03.2021 rreth orës 04.00 h, ne A.. ‘A..J..’ ka tentuar qe te udhëtoj per ne S..te T.. me qrast gjate kontrollevet e dokumenteve ka përdorur (prezantuar) leje qëndrimin e G.. me nr. GR:4.... i vendosur ne faqen e 7 (shtate) te pasaportës te Sh... nr.BA24..., dokument ky i cili dyshohej se ishte i falsifikuar, me qe raste te dyshuarit dokumenti ne fjale i eshte ndaluar dhe i eshte konfiskuar.

-me këtë ka kryer veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-se.

Andaj gjykata konformë neneve, 1, 2, 3, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, dhe nenit 390 par.1 të KPRK-së, si dhe nenin 365 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME GJOBE

Me dënim me gjobe ne shume prej 300.-€ (treqindeuro), e të cilën gjobë ka për detyrë ta paguaj pas plotëfuqishmërisë se këtij aktgjykimi në të kundërtën konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim ku do t'i llogaritet për një ditë burgimi shuma prej 20.-€.

DETYROHET i pandehuri që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të ia paguaj shumën prej 20-€, si dhe dhe shumën prej 30-€ për Fondin e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbasimit të dhunshëm.

Konforme nenit 282 pa.1 dhe 2 nen.par.2.5 të KPPK-se. Dokumenti i falsifikuar pra leja qëndrim i G... GR:4... se bashku me pasaportën e Sh... numër BA..., **KONFISKOHET**.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.II.nr.1049/21 dt.13.03.2021, e ka akuzuar të pandehurin A. B. nga C.- Sh..., për shkak të veprës penale Falsifikimi nga neni 390 par.1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar, ka mbetur në tërësi pranë aktit akuzues, dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili është bërë konform dispozitave ligjore me vullnet dhe pa presion, dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar, ka deklaruar se e pranon fajsinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe njëherit ka shtuar se ndihet i penduar për atë që e ka bërë, gjithashtu ka shtuar se është mbajtës i familjes dhe është në gjendje jo të mirë ekonomike, e ka lutur gjykatën që ti shqiptojë një dënim sa më i butë.

Mbrojtësi i të pandehurit është pajtuar me pranimin e fajësive nga ana e klientit të tij dhe paraprakisht ia kam shpjeguar venifitet që i parasheh ligji me rastin e pranimit të fajësive dhe i propozoj gjykatës që pasi të vlerësoj rrethanat lehtësuese të cilat i përmendi vet i pandehuri ti shqiptojë një dënim sa më i butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme nga ana e të pandehurit dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuzën, dhe se aktakuzën nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK-së, gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të të pandehurit, për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese, gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprës penale pra faktin se i njëjti për here të parë ka rënë nën dëshirë me ligjin, personale dhe familjare, pra faktin se i pandehuri është i moshës së re dhe len për tu kuptuar se në të ardhmen do të bëhet anetar i dobishëm i shoqërisë dhe është i gjendjes së dobët ekonomike, sjelljen pas kryerjes së veprës penale, pra faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do t'i përsërisë veprat e tilla apo të ngjajshme, e veqanërisht pranimin e fajësive ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoj, shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit, pra faktin se i njëjti ka qenë i aftë në kohën e kryerjes së veprës penale t'i kuptoi sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marrë për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, andaj të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë i bindur se një dënim i tillë do të arrihet qëllimi i tillë konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 450 par. 1 dhe 2 pika 1 dhe 6 të KPPK-së, ku shuma prej 20.-€, për paushall gjyqësor u bazua në bazë të ndërlikueshmërisë së rastit, ndërsa shuma prej 30.-€, u bazua në nenin 39 të Ligjit për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit.

Vendimi për konfiskimin e dokumentit u bazua në nenin 282 të KPPK-se.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN.

P.nr.102/21 dt.13.03.2021.

**Zyrtarja ligjore
Elmije Troshupa**

**GJYQTARI
Avdirrahman Gashi**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.